



51/2  
2221

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA  
DREJTORIA E MENAXHIMIT, PROJEKTEVE DHE MONITORIMIT  
DREJTORIA E MENAXHIMIT, MONITORIMIT DHE REGJISTRIT TË ZONAVE  
TË MBROJTURA  
SEKTORI I MENAXHIMIT

Nr. 1912/1 prot.

Tiranë, më 02.06.2023

Lënda: Kthim përgjigje

**Z. DORIAN MATLIJA**  
**DREJTOR EKZEKUTIV**  
**QENDRA "RES PUBLIKA"**

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.24H.3, Ap.7

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 51/23, datë 26.05.2023 "Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit", protokolluar me tonën me shkresë nr. 1912 prot, datë 29.05.2023, lidhur me kërkesën e një qytetari, lidhur me ndërtimin e HEC "KUÇ", nga shoqëria "Age Kuç" sh.p.k, drejtuar Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, ju bëjmë me dije se:

Lidhur me ndërtimin e HEC "KUÇ", nga shoqëria "Age Kuç" sh.p.k, me vendndodhje në rrjedhën e sipërme të pellgut ujëmbledhës të lumit të Shushicës, bashkia Himarë, qarku Vlorë, AKZM është shprehur me "dhënie mendimi", në Qeshor të vitit 2022, se sipërfaqja ku kërkon të zhvillohet aktiviteti, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura (*bashkëlidhur gjeni mendimin*).

Parku Kombëtar "Lumi Vjosa", është shpallur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 155, datë 13.03.2023 "Për shpalljen e ekosistemit natyror të Lumit Vjosa "Park Kombëtar", kategoria e I" (9 muaj pas dhënies së mendimit)

Referuar VKM nr. 155/2023 "Për shpalljen e ekosistemit natyror të Lumit Vjosa "Park Kombëtar", kategoria e II", si dhe miratimit të kufirit, sipërfaqja ku do të ndërtohet vepra e marrjes së këtij HEC-i, rezulton brenda territorit të PK "Lumi Vjosa", në nënzonën qendrore (ZQ).

Sipas VKM-së së mësipërme, për nënzonën qendrore, shënuar në hartë me ZQ, citohet se: "Në këtë zonë zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes (strikte), pasi performanca natyrore e saj është tepër e lartë, më pak ose aspak e shqetësuar nga veprimtaritë njerëzore. Ka përparësi ruajtjen tërësore të natyrës, biodiversitetit, të llojeve të rrezikuara, monumentet e natyrës, të peizazhit unik tërësor, veçoritë natyrore të jashtëzakonshme gjeomorfologjike dhe historike pa qënë nevoja e ndërhyrjeve përmirësuese të përhershme, të cilat menaxhohen në atë mënyrë që të ruajnë gjendjen natyrore, të mbështesin lehtësimin e kërkimit shkencor dhe monitorimin mjedisor. Kjo

zonë gëzon karakterin e mbrojtjes strikte dhe detajohet sipas përcaktimeve të bëra në planin e menaxhimit. Në këtë zonë lejohen kërkimi shkencor, zhvillimi i veprimtarive ekoturistike të lira në natyrë”.

**Sa më sipër, ky aktivitet nuk mund të zhvillohet.**

Për këtë është informuar edhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

**I KOMANDUAR NË DETYRË  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
Daniel PIRUSHI**





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA  
DREJTORIA E MENAXHIMIT, PROJEKTEVE DHE MONITORIMIT

**Lënda:** Dhënie mendimi

Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti “Ndërtim i HEC Kuç”, me zhvillues “AGE KUÇ” dhe aplikues “AGE KUÇ”, me nr. Aplikimi AN010320220007, nuk shtrihet në zonë të mbrojtur.

**I KOMANDUAR NË DETYRË  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Daniel PIRUSHI**

Daniel  
Pirushi

Digitally signed by  
Daniel Pirushi  
Date: 2022.06.03  
05:38:00 +0200